


Statistikat Tregtare te Kosovës, Tregtia e jashtme e mallrave, eksporti-importi me Turqinë

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), shkëmbimi tregtar me Turqinë¹, në vitin 2025 deficitin tregtar ka shënuar një rritje prej 2.9% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, duke arritur në -902.7 milionë euro nga -877.6 milionë euro sa ishte në 2024. Mbulueshmëria e importit nga eksporti mbetet e ultë vetëm rreth 3.5%.

Figura 1. Bilanci tregtar i mallrave me Turqi sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Tabela 1. Bilanci tregtar i mallrave në milionë euro, në % mbulueshmëria dhe rritje (v-m-v)

Viti	2022	2023	2024	2025
Eksport	23.5	20.2	27.5	33.2
Import	843.0	796.6	905.2	935.8
Bilanci tregtar	(819.5)	(776.3)	(877.6)	(902.7)
% e mbulimit	2.8%	2.5%	3.0%	3.5%
Rritje Exp. (v-m-v) %	34.8%	-13.7%	36.1%	20.4%
Rritje Imp. (v-m-v) %	44.3%	-5.5%	13.6%	3.4%
Bila. Treg. (v-m-v) %	44.6%	-5.3%	13.0%	2.9%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)


¹ Turqia, zyrtarisht Republika e Turkiye-s, është një vend në Evropën Juglindore, me kryeqytet Ankara. Ka një sipërfaqe prej 783,562 km² me rreth 86.1 milionë banorë. Bruto Prodhimi Vendor (GDP) Nominal për 2025 vlerësohet rreth 1.57 trilionë \$ (dollar amerikan), me të ardhura për kokë banori (per capita) rreth 18,198 \$ (dollar amerikan), e renditur si ekonomia e 17-të më e madhe në botë nominalisht sipas FMN-së.

Analizuar në periudhën e fundit marrëdhëniet tregtare të mallrave ndërmjet Kosovo dhe Turqisë karakterizohen nga një deficit i lartë dhe i vazhdueshëm tregtar në favor të Turqisë gjatë periudhës 2022–2025. Eksportet e Kosovës drejt Turqisë janë rritur me një mesatare vjetore prej 19.4%, ndërsa importet kanë shënuar një rritje mesatare vjetore rreth 14.0%. Importet nga Turqia (në sasi dhe në vlerë) dominojnë dukshëm ndaj eksporteve të Kosovës, duke reflektuar varësinë relativisht të madhe të tregut kosovar nga produktet turke.

Si rezultat i këtij trendi të pabarabartë tregtar, bilanci tregtar i mallrave ka mbetur vazhdimisht negativ për Kosovën. Pavarësisht rritjes dyshifrore të eksporteve në vitin 2025 (20.4%), vëllimi i tyre mbetet i pamjaftueshëm për të balancuar rritjen nominale të importeve, duke bërë që deficitin tregtar në vitin 2025 të arrijë në 902.7 milionë euro.

Tregusit e mbulueshmërisë tregojnë një pabarazi të thellë, shkalla e mbulimit të importeve me eksporte sillet rreth 2.8% sa ishte në vitin 2022 deri në 3.5% në vitin 2025.

Figura 2. Eksport/Importi me Turqinë sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)


Gjatë vitit 2025 vlera e mallrave të eksportuara për në Turqi ishin rreth 33.2 milionë euro apo 3.5% si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm. Turqia renditet e shtata në listën e 10 vendeve kryesore të eksportit.

Importi i mallrave nga Turqia arritën në 935.8 milionë euro apo 13.3% si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm, renditet e dyta në listën e 10 vendeve kryesore të importit.

Struktura e Eksportit/Importit me Turqi në 2024 - 2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve

Sipas të dhënave nga Open_DATA Doganat e Kosovës(DK) për vitin 2025 grupet kryesor të Eksportit e përbëjnë: 43.2% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 32.4% Tekstil dhe artikuj tekstili; 8.2% Letër dhe artikuj prej letëre; 3.8% Lëkurë dhe artikuj prej tyre; 3.7% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre; 2.5% Makineri, paisje mekanike dhe elektrike 1.3% Produkte bimore etj. si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm me Turqinë.

Figura 3. Struktura e Eksportit 2024-2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve në %




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës(DK)

Rritja e eksporteve për 20.4% apo rreth 5.6 milionë euro më shumë mallra në tregun turk në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rritja te sektorët si, Metalet bazë dhe artikujt prej tyre (nga 26.4% në 43.2%) dhe një rritje e lehtë te Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre (nga 2.8% në 3.7%) etj.

Te Importet për vitin 2025, kemi këtë renditje të sektorëve-grupe kapitujve kryesor si në vijim: 27.1% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 16.4% Tekstil dhe artikuj tekstili; 12.2% Makineri, paisje mekanike dhe elektrike; 7.1% Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 6.3% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre; 6.0% Produkte të industrisë kimike; 4.6% Druri dhe artikuj druri, etj. si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm nga Turqia.

Figura 4. Struktura e Importit 2024 - 2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës (DK)

Rritja e importeve për 3.4% apo rreth 30.6 milionë euro më shumë mallra të importuara në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rritja e sektorëve si Metalet bazë dhe artikujt prej tyre (nga 22.3% në 27.1%) dhe një rritje e lehtë të Tekstil dhe artikuj tekstili (nga 15.4% në 16.4%).